

Po afron 28 Nëntori, dita kur shumë nga ju do të dynden drejt Vlorës, ashtu siç bëni çdo vit. Po afron edhe viti 2022, viti kur e gjithë shqiptaria do të dyndet drejt Vlorës, siç bën çdo përvjetor, por këtë radhë Vlora nuk do të ketë sikletin e mikpritjes së miqve të shumtë, të vëllezërve dhe motrave, sikurse zemërmadhi i druhet frikës se mos nuk i përmbush pritshmëritë e mikpritjes, sepse këtë herë Vlora ka plot dhoma të reja për miqtë dhe plot bukuri të shtuara në qytet. Unë u gëzohem çdo ditë bukurive të Vlorës dhe jo pa krenari, sepse mendoj se ky është një qytet i pavdekshëm. Vlora është qytet feniks, sepse, ashtu si feniksi, u ringjall nga hiri i vet dhe nga kryedeputeti i vet, i cili vendosi se Vlora nuk duhet të ketë vendin qendror vetëm në histori, sepse këtë ia ka dhënë Ismail Qemali 110 vjet më parë, por duhet të ketë vendin qendror edhe në turizëm, sepse këtë ia caktoi Zoti që ditën kur krijoi botën. Edi Rama i mbajti premtimet e tij. Sot Vlora është një qytet me bukuri të shtuara dhe me vlera pa fund. A jemi këtu për buxhetin?! Po, për buxhetin jam edhe unë dhe kam një lajm të mirë për vlonjatët. Buxheti i ri e mban ende Vlorën qytet strategjik. Ky buxhet respekton vlonjatin, sepse e vendos në qendër, natyrisht, për aq sa mundet në një vit postraumatik, por kjo është një ngjitje që ka filluar që në vitin 2013 dhe nuk ka kthim pas. Ka vetëm një instrument për të matur këtë të vërtetë dhe ai është niveli i jetesës së qytetarit. A jetojnë më mirë vlonjatët sot?! Sigurisht që po. A do të jenë më mirë ata nesër?! Patjetër që po! Po ju tregoj se çfarë sjell ky buxhet.

Më shumë investime që prodhojnë zhvillim, sepse nuk janë vetëm 63% më shumë se mesatarja e 5 vjetëve të fundit, por, njëkohësisht, janë investime që ngrenë në një nivel të ri industrinë turistike të Vlorës, duke i shtuar aeroport, bajpas, port jahtesh dhe port turistik, pa harruar rrugën e vjetër Fier-Vlorë dhe vazhdimin e shëtitores. Kjo industri, industria e turizmit, do të vijojë të plotësohet me perlat e trashëgimisë kulturore dhe historike, siç është rehabilitimi i Sheshit të Flamurit dhe Kullës së Sahatit emblematik të qytetit. Ky buxhet nuk ka vetëm tulla e beton, sepse janë dhjetëra projekte ujësjellësish për t'u financuar, sidomos në zonat rurale, ku dëshira për ujë të pijshëm të mos ngelet thjesht dëshirë. Ky buxhet nuk është vetëm për qytetin, por, akoma më shumë është për fshatin. Do të ketë një buxhet më të mirë për një bujqësi më të aftë, e cila të mund ta plotësojë paketën turistike me prodhim vendas, pse jo edhe të çajë tregjet ndërkombëtare, sepse në listë janë dhjetëra projekte për ndërtimin dhe përmirësimin e sistemit të kullimit dhe të vaditjes. Ky buxhet ka menduar edhe për menaxhimin më të mirë të fatkeqësive natyrore, duke parashikuar rehabilitimin e argjinaturave dhe hidrovoreve në të gjithë qarkun e Vlorës. Në fokus mbetet mbështetja sociale dhe reduktimi i varfërisë. Fondi për pagesën e papunësisë në vitin 2022 është, pothuajse, trefish më i lartë se në vitin 2017 dhe ruhet përmirësimi i viteve të fundit për ndihmën ekonomike. Në këtë buxhet lexohet qartë kujdesi i qeverisë për shëndetin publik, sepse ai siguron një personel shëndetësor të paguar më mirë, si dhe një infrastrukturë mjekësore me kapacitet të shtuar. Në këtë buxhet lexohet edhe objektivi afatmesëm i qeverisë për ta kthyer arsimin në një instrument thelbësor për luftën ndaj varfërisë dhe zhvillimin rajonal të qëndrueshëm.

Me këtë buxhet hidhet vështrimi përtej emergjencës së të sotmes, si dhe hidhen hapa të guximshëm drejt atij që quhet "objektivi i zhvillimit të qëndrueshëm". Në listë ka, gjithashtu, disa projekte, që shkojnë drejt këtij objektivi, siç është ai i rehabilitimit të Lumit të Vlorës apo i disa projekteve për menaxhimin e mbetjeve. Këto janë disa nga arsytet që ky buxhet na jep për të pritur një jetë akoma më të mirë për qytetin e Vlorës, por kjo nuk lidhet vetëm me Vlorën, sepse të tillë tregues cilësorë do të flasin, patjetër, për një jetë më të mirë në çdo qytet të Shqipërisë. Kjo, përveç të tjerash, vjen edhe si rezultat i rritjes së eficiencës që decentralizimi po sjell gjithmonë e më dallueshëm përmes shifrave

që prej vitit 2017. Shifrat flasin për më shumë të ardhura në buxhetet vendore, 76% më shumë në taksat lokale dhe 23% më shumë në taksën mbi pasurinë për vitin 2021. Ajo që presim më shumë në buxhetet vendore është një rritje në peshën që zënë investimet në listën e shpenzimeve, sepse është pikërisht ky zë që gjeneron rritje ekonomike dhe për momentin zë vetëm 20%. Të nderuar kolegë, Unë mendova të theksoj cilësinë që ky buxhet premtan për qytetin tim në veçanti, por ai, në fakt, është një lajm i mirë për të gjithë shqiptarët, sepse ai shfrytëzon të gjitha energjitë pozitive që një qeveri, në një vend në zhvillim si Shqipëria, mundet të gjenerojë në emër të përgjegjësisë për sot, por edhe të përgjegjësisë për nesër. Qeveria, në emër të përgjegjësisë për të sotmen, guxoi të rrisë barrën e borxhit për t'iu kundërpërgjigjur goditjeve të rënda të natyrës. Është po kjo qeveri që në emër të përgjegjësisë për të ardhmen, merr përsipër, përmes këtij buxheti që po miratojmë, të rifusë deficitin buxhetor në trajektoren konsoliduese, duke e ulur atë në 2,4% të GDP-së në vitin 2024. Në të njëjtën trajektore orientohet edhe borxhi publik. Unë nuk do të rendis shifra e përqindje për të treguar avantazhet që ka ky buxhet për sa u përket statistikave apo anës strukturore të tij, sepse këtë e bëjnë më mirë ekspertët e fushës, por ka një emërues të përbashkët që i bën të matshme, të krahasueshme dhe, rrjedhimisht, të pakundërshtueshme të gjitha vendimet që po merren nëpër rreshtat e këtij buxheti dhe ai është efekti që ky buxhet ka në përmirësimin e jetës së përditshme dhe në mirëqenien e çdo shqiptari.

Projeksionet që ky buxhet mbështet tregojnë një rritje të GDP-së për frymë, ku nga 13845 dollarë që ishte në vitin 2018, në 16296 dollarë në vitin 2022, ku rritja do të vijojë edhe në vitin 2024. Kjo i jep përgjigje çdo debati. Ndaj, unë, si vlonjat pasionant, them se ky buxhet zgjeron horizontin blu, si shqiptar racional them se ky buxhet është më i miri i mundshëm në kohët e vështira që jetojmë, ndërsa si deputet i Vlorës them se ky buxhet vendos standarde të reja, duke na lejuar të pretendojmë më shumë për të ardhmen dhe të guxojmë më shumë për të, sepse, tek e fundit, edhe Zoti pëlqen t'i ndihmojë guximtarët. Faleminderit!